

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"****Njoftim për vend të lirë pune**

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 57; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", nenet 47, 52, shpall konkursin për personel akademik, si më poshtë:

- 1 (një) personel akademik me angazhim me kohë të pjesësoshme dhe kontratë me kohëzgjatje të caktuar, pranë njësisë bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, si më poshtë vijon:

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

- të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë "Bachelor" në fushën e Historisë apo Histori-Gjeografisë, në sistemin me kohë të plotë (brenda apo jashtë vendit);
- të kenë fituar diplomën "Master i Shkencave" ose diploma ekuivalente me të në fushën e Historisë apo Histori-Gjeografisë (fituar brenda apo jashtë vendit);
- të kenë notë mesatare të përgjithshme të të dy cikleve të studimit jo më pak se 8 (tetë);
- të kenë njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht) e vërtetuar me dëshmi;

Kritere të tjera

- të kenë botime në revista shkencore/pjesëmarrje në seminare kombëtare dhe ndërkombëtare të vërtetuara me dëshmitë përkatëse, në fushat e historisë, marrëdhënjëve ndërkombëtare, turizmit, marketingut, ndihmës së parë etj;
- të kenë përvojë në fushën e veprimtarive turistike dhe të ndihmës së parë;
- të kenë aftësi të mira komunikuese e të punuarit në grup

Kanë përparësi kandidatët që kanë fituar gradën shkencore "Doktor" ose të jenë në proces në fushën e Historisë, Gjeografisë, Turizmit.

- 2 (dy) personel akademik me angazhim me kohë të pjesësoshme dhe kontratë me kohëzgjatje të caktuar, pranë njësisë bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

- a) Të kenë përfunduar studimet "Bachelor" dhe "Master i Shkencave", në sistemin me kohë të plotë, në fushën e Informatikës, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Elektronikës, ose diplomë ekuivalente me to (me sistemin e vjetër të studimeve), me notë mesatare të përgjithshme, për çdo program studimi mbi 8(tetë);
- b) Në rast se i interesuari zotëron një diplomë të marrë në universitete të huaja, kërkohet që të jetë ekuivalentuar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.;

Preferohen kandidatët:

- me titull akademik, gradë shkencore "Doktor" (PHD), ose "Master Ekzekutiv" në fushën e Informatikës ose të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
- që kanë përfunduar programe studimi në Informatikë;

- njohës të një gjuhe të Bashkimit European (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), sipas testeve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me përjashtim të atyre që kanë përfunduar në njërin prej cikleve të studimit në një nga këto gjuhë të huaja;
  - me eksperiencë në mësimdhënie universistare;
  - me aftësi të mira komunikuese dhe të punës në gup;
  - me aktivitet botues dhe referues, në revista shkencore ose konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të njohura zyrtarisht.
3. 2 (dy) personel akademik me angazhim me kohë të pjesësishme dhe kontratë me kohëzgjatje të caktuar, në fushën e ekonomisë, pranë Njesisë Bazë të Kontabilitet Financës.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

- a. të kenë përfunduar studimet universistare të ciklit të parë “Bachelor” në fushën e ekonomisë apo drejtësisë, në sistemin me kohë të plotë (brenda apo jashtë vendit) me notë mesatare mbi 7.5 (shtatë.pesë);
- b. të kenë të paktën diplomën “Master i Shkencave” ose diplomë ekuivalente në fushën e ekonomisë apo të drejtësisë (fituar brenda apo jashtë vendit) me notë mbi 7.5 (shtatë.pesë);
- c. diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura pranë MAS;
- d. të zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht) e vërtetuar me dëshmi, përmes testeve ndërkombëtare miratuar nga MAS-i ose dëshmi të mbrojtjes së gjuhës së huaj para kohës të miratimit të listës nga MAS-i;
- e. të kenë aftësi të mira komunikuese e të punuarit në grup;

Kanë përparësi kandidatë që:

- kanë titull akademik;
- kanë gradë shkencore;
- janë diplomuar jashtë shtetit;
- kanë përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë;
- kanë botime në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.

4. 1 (një) personel akademik me angazhim me kohë të pjesësishme dhe kontratë me kohëzgjatje të caktuar, në fushën e ekonomisë, pranë Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

- a. të kenë përfunduar studimet universistare të ciklit të parë “Bachelor” në fushën e ekonomisë (brenda apo jashtë vendit);
- b. të kenë fituar diplomën “Master i Shkencave” ose diploma ekuivalente me të në fushat përkatëse (fituar brenda apo jashtë vendit);
- c. të ketë notë mesatare mbi 7 (shtatë) për të dy ciklet e studimit;
- d. të kenë njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht) e vërtetuar me dëshmi;
- e. të kenë aftësi të mira komunikuese e të punuarit në grup;

Kanë përparësi kandidatët që:

- kanë titull akademik;
- kanë gradë shkencore;

- janë diplomuar jashtë shtetit;
- kanë përvojë në mësimdhënie.
- kanë botime në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.

5. 1 (një) personel akademik me angazhim me kohë të pjesësoshme dhe kontratë me kohëzgjatje të caktuar, pranë Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

- të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë "Bachelor" në Turizëm, Trashëgimi Kulturor apo fusha të përafërta me to (brenda apo jashtë vendit);
- të kenë diplomën "Master i Shkencave" ose diploma ekuivalente me të në fushat përkatëse (fituar brenda apo jashtë vendit);
- të kenë njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht) e vërtetuar me dëshmi;
- të kenë eksperiencë për hartimin dhe aplikimin e projekteve të financuara nga Programet e Bashkimit Europian;
- të kenë aftësi të mira komunikuese e të punuarit në grup;

Kanë përparësi kandidatët që:

- kanë titull akademik;
- kanë gradë shkencore;
- janë diplomuar jashtë shtetit;
- kanë përvojë në mësimdhënie;
- kanë botime në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët që konkurojnë;

1. Kërkesë me shkrim;
2. Jetëshkrim sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
4. Kopje të diplomës dhe të listës së notave përkatëse (të notuara). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të dorëzohet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (Raport mjekësor për aftësitë në punë);
7. Vërtetim i gjëndjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
8. Dokumentacion nga institucioni ku ka punuar që nuk është marrë ndaj tyre masa disiplinore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera në jetëshkrim;
10. Dëshmi penaliteti.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje. Kandidatët do të vlerësohen për aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell s'kualifikim të kandidatit. Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nga një komision ad-hoc. Konkursi zhvillohet pranë Universitetit "Eqrem Çabej". Dokumentat, të noterizuara brenda tre muajve të fundit, dorëzohen pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakadematike Administrative në Universitetin "Eqrem Çabej".

Afati i fundit i pritjes së aplikimeve është brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit.